



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr.1771/2 Prot.

Tiranë, më 05/12/ 2019

V E N D I M

Nr. 180, Datë 05 /12/ 2019

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, bazuar në nenin 32, pika 1, gërma “a”, të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, mori në shqyrtim ankesën nr.150 regj, datë 20.11.2019, që i përket ankuesit L.R, në të cilën pretendohet diskriminim për shkak të “*gjendjes arsimore*” dhe “*çdo shkak tjetër*”, nga ana e Bashkisë Fier. Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi¹,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Ankuesi parashtron se, ka qënë i punësuar pranë ish-Komunës Cakran, tani Njësia Administrative Cakran në varësi të Bashkisë Fier, në zyrën e tatimeve. Më pas ankuesi ka kaluar në pozicionin e administratorit të përkrahjes sociale dhe më pas në postin e inspektorit të tatim taksave në ish Komunën Cakran. Me urdhrin nr. 401, datë 17.09.2015 Bashkia Fier ka urdhëruar ndërprerjen e marrëdhënieve financiare dhe të punës për shkak të ristrukturimit të Bashkisë Fier. Nga momenti i njoftimit të ndërprerjes së marrëdhënies financiare dhe të punës, ankuesi është paraqitur në institucion dhe në vendin e punës duke kryer aktivitetin e punës për rreth 6 muaj deri sa ka adhur zëvendësuesi. Që nga momenti i ndërprerjes së marrëdhënieve të punës gjatë gjithë këtyre viteve ankuesi ka kërkuar vazhdimisht të drejtën për lëshimin e librezës së punës. Ankuesi shprehet se akoma edhe sot institucioni nuk i ka lëshuar librezën e punës, duke e penguar në këtë mënyrë për tu punësuar diku tjetër dhe duke i shkaktuar një dëm të madh jo vetëm financiar por edhe psikologjik.

¹Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën Komisioneri.

Adresa: Rruga e Durrësit, Nr.27, Kodi Postar 1001, Tiranë, Tel: +355 4 2431078, e-mail: info@kmd.al, web: www.kmd.al

Ankuesi deklaron se ndihet i diskriminuar për arsye se, ai është larguar nga puna duke qenë me arsim të lartë dhe është mbajtur në punë një person me arsim të mesëm dhe për faktin se nuk i lëshojnë librezën e punës, në mënyrë që të punësohet diku tjetër sipas kritereve të përcaktuara nga DAP.

Në përfundim ankuesi kërkon nga Komisioneri që të hetojë rastin e tij dhe të zgjidh këtë problem të madh para të cilit gjendet prej kaq vitesh.

II. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se:

Komisioneri mori në shqyrtim ankesën bazuar në kompetencën e parashikuar nga neni 32, pika 1, gërma “a”, të ligjit nr. 10221/2010 “*Për mbrojtjen nga diskriminimi*”, që i jep të drejtën për të shqyrtuar ankesat nga personat ose grupet e personave që pretendojnë se janë diskriminuar, sipas parashikimeve të këtij ligji.

Ligji Nr. 10 221/2010 “*Për mbrojtjen nga diskriminimi*”, rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me një listë jo shteruese shkaqesh, duke përfshirë “*gjendjen arsimore*” të pretenduar si shkak diskriminues nga ankuesi. (neni 1²). Ligji “*Për mbrojtjen nga diskriminimi*”, në nenin 12/1³, ndalon çdo lloj dallimi, kufizimi ose përjashtimi që i bëhet një personi në lidhje me të drejtën e tij për punësim dhe që bazohet në gjendjen e tij arsimore. Në mënyrë të veçantë ligji “*Për mbrojtjen nga diskriminimi*”, në nenin 12, ndalon diskriminimin për shkak të gjendjes arsimore, ndër të tjera në lidhje me largimin nga puna dhe zgjidhjen e kontratës së punës.

Diskriminimi përkufizohet nga ligji “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*” në nenin 3, pika 1, si “*çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi.*

Në bazë të nenit 7, të Ligjit 10 221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”⁴, mbrojtja nga diskriminimi, garantohet nga çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i

² Neni 1, të ligjit nr. 10221/2010: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, **gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.”**

³ Neni 12/1, të ligjit nr. 10221/2010: “Ndalohet diskriminimi i personit në lidhje me të drejtën e tij për punësim. Diskriminimi përfshin çdo dallim, kufizim ose përjashtim që bazohet në shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe që, ndër të tjera, ka lidhje me: c) trajtimin e punëmarrësve në vendin e punës, duke përfshirë trajtimin e tyre gjatë vendosjes ose ndryshimit të kushteve të punës, shpërblimin, përfitimet dhe mjedisin e punës, trajtimin lidhur me trajnimet profesionale ose gjatë procesit disiplinor apo **lidhur me pushimin nga puna ose zgjidhjen e kontratës së punës**;.....”

⁴ Neni 7/1, i ligjit nr. 10221/2010 “*Për mbrojtjen nga diskriminimi*”, parashikon: “Çdo veprim apo mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që

Adresa: Rruga e Durrësit, Nr.27, Kodi Postar 1001, Tiranë, Tel: +355 4 2431078, e-mail: info@kmd.al, web: www.kmd.al

personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë.

Bazuar në shqyrtimin paraprak të ankesës dhe bazuar në dokumentacionin e paraqitur nga ankuesi, Komisioneri konstaton se:

Ankuesi L.Ruçaj, ka përfunduar studimet e larta në Universitetin e Vlorës Ismail Qemali në Fakultetin e Ekonomisë dhe Drejtësisë, Dega Turizëm, ku edhe ka marrë titullin “menaxher turizmi”, fakt ky që rezulton nga Diploma Nr. 453, lëshuar më datë 25.07.2008, nga Universiteti i Vlorës “*Ismail Qemali*”. Me vendimin nr. Extra prot datë 02.08.2007 të Kryetarit të Komunës Cakran, ankuesi ka filluar punë si inspektor i tatim taksave pranë ish Komunës Cakran. Bazuar në urdhrin nr. 401 datë 17.09.2015, të Kryetarit të Bashkisë Fier, ankuesit i janë ndërprerë marrëdhëniet financiare dhe ato të punës si ish punonjës në ish Komunën Cakran, për shkak të ristrukturimit të Bashkisë Fier. Me kërkesën e datës 23.03.2018 ankuesi i është drejtuar Njesisë Administrative Cakran për plotësimin e librezës së punës, ndërsa me një kërkesë të dytë që mban datën 21.08.2019 ai i është drejtuar Bashkisë Fier duke i kërkuar kopje të dosjes personale, librezën e punës me shënimet përkatëse si dhe të gjithë praktikën dokumentare të ndjekur për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës të ankuesit, si ish punonjës i Komunës Cakran.

Bazuar në faktet dhe kërkimet e parashtruara nga ankuesi, dokumentacionin e depozituar si dhe bazuar në nenin 33, pika 4, gërma “dh”, të Ligjit nr. 10221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, i cili parashikon se : “ *Ankesa nuk pranohet nëse : paraqitet më vonë se tre vjet nga ndodhja e diskriminimit ose më vonë se një vit nga marrja dijeni nga i dëmtuari, për këtë fakt.* ”, Komisioneri vlerëson se ankesa nuk pranohet për arsyet e mëposhtme:

Së pari, në lidhje me kërkimin e ankuesit se ndihet i diskriminuar pasi ai është larguar nga puna edhe pse ishte me arsim të lartë dhe në punë është mbajtur një person pa arsim të lartë, Komisioneri vlerëson se ky kërkim është përtej afateve të përcaktuara nga neni 34/4/dh të ligjit nr. 10221/2010. Largimi nga puna e i ankuesit ka ndodhur në vitin 2015 nëpërmjet urdhrit nr. 401 datë 17.09.2015, pra katër vjet nga paraqitja e ankesës e cila mban datën 20.11.2019 dhe rezulton se ankuesi ka patur dijeni për largimin nga puna që nga momenti i daljes së urdhrit.

Së dyti, në lidhje me pretendimin e ankuesit se është diskriminuar pasi nuk i jepet librezë e punës, Komisioneri vlerëson se edhe ky kërkim është përtej afateve, të përcaktuara nga neni 34/4/dh të ligjit nr. 10221/2010. Që në momentin e largimit nga puna, ankuesi ka patur të drejtën të pajiset me librezën e punës me shënimet përkatëse për periudhën që ai ka qënë i punësuar. Ankuesit i ka lindur e drejta për t’u pajisur me librezën e punës nga punëdhënësi që në datën 17.09.2015, pasi

krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash, përbën diskriminim”.

me urdhrin 401 datë 17.09.2015 atij i janë ndërprerë njëkohësisht marrëdhëniet financiare dhe ato të punës. Pra, nga momenti i largimit nga puna datë 17.09.2015 e deri në datën e paraqitjes së ankesës 20.11.2019 kanë kaluar më shumë se katër vjet. Ankuesi shprehet se në mënyrë të vazhdueshme e ka kërkuar librezën e punës, çka tregon se ai ka patur dijeni për faktin e pretenduar si diskriminues, pra mosdhënien e librezës së punës. Megjithatë edhe nëse do ta konsideronim se ankuesi ka marrë dijeni për diskriminimin jo në momentin e ndodhjes së diskriminimit, që është momenti i ndërprerjes së marrëdhënieve të punës kur ankuesit duhet t'i ishte dorëzuar librezë e plotësuar, por në një moment të dytë, dhe do ta lidhnim momentin e marrjes dijeni me momentin kur ai e ka kërkuar librezën e punës por nuk i është dhënë, edhe në këtë rast ankuesi është jashtë afatit 1 vjeçar të parashikuar nga nenin 33/4/dh. Rezulton se ankuesi ka depozituar një kërkesë pranë Njesisë Administrative Cakran më datë 23.03.2018, me anë të së cilës ka kërkuar plotësimin e librezës së punës. Nëse do ta konsiderojmë datën 23.03.2018 si moment të marrjes dijeni për faktin diskriminues edhe në këtë rast ankesa e paraqitur nga ankuesi e cila mban datën 20.11.2019, është jashtë afatit 1 vjeçar të parashikuar nga neni 33/4dh të ligjit nr. 10221/2010.

Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës, lidhur me sa sipërcituar, Komisioneri arrin në përfundimin se nuk përmbushen kriteret ligjore për pranimin e ankesës, të përcaktuara nga neni 33, pika 4, gërma “dh”, të ligjit nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.

PËR KËTO ARSYE :

Bazuar në nenin 21, pika 1, nenin 32, pika 1/a, nenin 33, pika 4, gërma “dh”, neni 33 pika 10 të Ligjit nr.10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Mospranimin e ankesës së z. L. R.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankimim në gjykatë, brenda afatit 45 ditor nga marrja dijeni, sipas parashikimeve ligjore të Kodit të Procedurës Administrative, të ndryshuar.

KOMISIONER

Robert GAJDA